



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.05.2018, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Vazhdimi i shqyrtimit nen për nen dhe miratimi në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve””.

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Silva Caka, Elena Xhina, Arben Pëllumbi.

#### **Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Edmond Panariti dhe Tom Doshi.

#### **Të ftuar:**

Toni Gogu- Zëvendësministër i Drejtësisë

Adrian Shega - Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit

Katrin Treska- Drejtoreshë e Çështjeve Rregullatorë të Drejtësisë.

Agnes Bernhard- shefe e misionit EURALIUS

Drita Avdyli – Kryetare e Dhomës së Ndërmjetësve

Enila Hasani, drejtoreshë e Departamentit Ligjor dhe Trajnimeve pranë Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve.

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** - Përshëndetje të gjithëve!

Meqenëse kuorumi është i plotësuar, vazhdojmë mbledhjen e Komisionit sipas rendit të ditës. Sot kemi vazhdimin e shqyrtimit nën për nën dhe miratimin në tërësi të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve””. Komisioni ynë është komision përgjegjës, relator është kolegu Bledar Çuçi, data e shqyrtimit në seancë është 17.05.2018. Nga Ministria e Drejtësisë kanë konfirmuar pjesëmarrjen zoti Toni Gogu, zëvendësministër i Drejtësisë, zoti Adrian Shega, drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe i Harmonizimit të Legjislacionit dhe zonja Katrin Treska, drejtoreshë e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë. Nga misioni EURALIUS kanë konfirmuar pjesëmarrjen zonja Agnes Bernhard, shefe e misionit dhe nga Dhoma e Ndërmjetësimit kemi të ftuar kryetaren zonjën Drita Avdyli.

Ne kemi kaluar pjesën më të madhe të neneve të këtij projektligji dhe kemi lënë të hapur dy nene, nenin 7 të projektligjit, që është neni 7 germa “b” e pikës 5 sipas tekstit dhe nenin 21 të projektligjit, për të cilin misioni EURALIUS kishte një propozim për formulim me shkrim.

Vazhdojmë me nenin 7.

**Enila Hasani** – Përshëndetje, zoti kryetar!

Unë jam Enila Hasani, drejtoreshë e Departamentit Ligjor dhe Trajnimeve pranë Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve.

Lidhur me nenin 7, germa “b” e pikës 5, ne kemi rënë dakord që germa “b” të fshihet ose të shfuqizohet nëse është në ligjin aktual dhe në pikën 6 të nenit, pas fjalëve “Dosjes personale” të shtohet fjalia “si dhe shënimet në lidhje me organizimin e ndërmjetësve”. Pra, pika 6 të bëhet “Forma, përmbajtja dhe rregullat e administrimit të regjistrit të ndërmjetësve dhe dosjes personale, si dhe shënimet në lidhje me organizimin e ndërmjetësve”.

**Ulsi Manja**- Pra, propozohet që të hiqet pika 5...

**Enila Hasani** – Germa “b” e pikës 5.

**Ulsi Manja** – Germa “b” e pikës 5 të hiqet dhe në pikën 6 të shtohen fjalët “si dhe shënimet në lidhje me organizimin e ndërmjetësve...”

**Enila Hasani** – ...të rregullohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

**Ulsi Manja** – Ju lutem, pak më të qartë riformulimin.

**Enila Hasani-** Atëherë, “Forma, përmbajtja dhe rregullat e administrimit të regjistrit të ndërmjetësve dhe dosjes personale, si dhe shënimet në lidhje me organizimin e ndërmjetësve të rregullohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë”.

**Ulsi Manja** – Përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, a keni rënë dakord me Dhomën për këtë riformulim?

**Toni Gogu-** Po, jemi dakord, sepse i gjithë qëllimi i germës “b” ishte që në regjistr të pasqyroheshin edhe format e organizimit dhe, meqenëse një gjë e tillë mund të rregullohet në nenin 6, jemi dakord me propozimin e bërë.

**Ulsi Manja** – A ka një koment nga misioni EURALIUS?

**Agnes Bernhard** – *(përkthen përkthyesi)* Ne jemi dakord me këtë.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Relatori, zoti Çuçi?

**Bledar Çuçi** – Ne jemi dakord me këtë, por, mesa mbaj mend, herën e fundit diskutimi nuk ka qenë për këtë pikë, por për çështjen tjetër.

**Ulsi Manja-** E kemi lënë për këtë pikë, për nenin 21 dhe për bordin.

**Bledar Çuçi** – Dakord me këtë.

**Ulsi Manja** – Atëherë, kush është dakord me nenin 7?

**Bledar Çuçi** – Edhe një herë, më fal, por diskutimi nuk ka qenë për formën dhe përmbajtjen e regjistrit, por ka qenë për faktin nëse do të regjistrohen edhe ndërmjetës si individë studio apo zyra. Me sa kuptova, edhe pyetja që iu bë ministrisë dhe EURALIUS-it ishte për pjesën e parë, për rregullimin e regjistrit, ndërsa pjesa tjetër ka të bëjë faktin, nëse do të regjistrohen apo jo individë si ndërmjetës vetëm apo ashtu siç i kemi propozuar ne, individë dhe zyra. Këtu kam një pyetje, sepse pashë me kujdes edhe ligjet e ngjashme dhe nuk e kuptoj pse Dhoma këmbëngul, pasi edhe avokatët i regjistrojnë të dyja, edhe zyrën, edhe avokatët me licencë...

**Alket Hyseni** – Madje e kanë detyrim që t’i regjistrojnë.

**Bledar Çuçi** – Madje e kanë të detyrueshme thotë kolegu. Nuk e di se ku është problemi që ata të regjistrohen edhe si zyrë, sepse ata mund të organizohen edhe si zyrë dhe është një formë organizimi që njihet.

**Ulsi Manja** –Përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë kanë një përgjigje.

**Toni Gogu** – Përgjigjja është shumë e thjeshtë, pasi ne nuk duam të krijojmë lëvozhga të licencuara për shërbimin e ndërmjetësimit dhe të mos kemi profesionistë të licencuar. Pra, mund të shkojnë drejt licencimit të një lëvozhge, më falni që po përdor këtë fjalë, por lëvozhgë e kam fjalën për personin juridik si strukturë, që mund të kemi një strukturë me shërbim

ndërmjetësie, ku brenda mund të mos kishte asnjë të licencuar për këtë punë. Pra, ne duam të licencojmë individin, shërbimi shkon me individin, dhe personi juridik nuk mund të ushtrojë veprimtari pa pasur brenda individë. Mënyra se si ata organizohen e rregullojmë me urdhër të ministrit dhe e mbyllim aty.

**Ulsi Manja**- Pra, ju propozoni që mënyra e organizimit të rregullohet me urdhër të ministrit?

**Bledar Çuçi** – Besoj se të gjithë e kemi parasysh dhe nuk ia vlen të zgjatemi me diskutimin që për të krijuar një zyrë të tillë bashkimi me ndërmjetës duhet të jetë me ndërmjetës të licencuar dhe jo pa licencë. Kjo është e sqaruar në ligj, e rregulluar dhe e normuar, nuk ka asnjë lloj problemi. Kështu që unë si relator, i qëndroj asaj që duhet të jetë edhe si zyrë, në mënyrë që të nxisim format e organizimit, por gjithsesi komisioni le të vendosë.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zot Çuçi!

Zoti Hyseni, fjala për ju.

**Alket Hyseni** – Unë këmbëngul që regjistri është një mekanizëm transparence dhe kontrolli që i shërben ministrisë dhe nuk e kuptoj konfuzitetin e ministrisë. Ky regjistër është bërë me qëllimin që ministria dhe çdo ent publik t'i kenë evidentuar ndërmjetësit me çdo formë organizimi.

Për sa i takon pretendimit tuaj, ai nuk qëndron, sepse që të shkojmë te personi juridik është e kushtëzuar që duhet të ketë të licencuar për të regjistruar personin juridik. Pra, argumenti juaj, që nuk doni lëvizhga pa pasur brendinë, nuk mund ta kesh lëvizhgen pa brendinë, sepse është kusht që duhet të jenë të licencuar individualisht për t'u regjistruar si subjekt juridik.

Së dyti, këta individët që ti ke në regjistër, nesër të organizohen në një shoqëri që ti nuk e ke në regjistër, do t'i kontrollosh ti, do t'i kërkosh QKL-ës apo QKB-së nëse kanë ndonjë shoqëri të tillë dhe, nëse po, të të japin adresën? Jo, zotëri, ai do të jetë i regjistruar në atë regjistër, në mënyrë që ti si ministri, kushdo tjetër, por edhe individë të caktuar, që kanë të drejtë të marrin informacion dhe që do të kryejnë veprimet, duan të dinë nëse ky subjekt është i regjistruar, ose i licencuar dhe nëse te regjistri online i ministrisë shikojnë se ky subjekt është i regjistruar, atëherë unë mund t'i ofroj shërbimin. Prandaj, qëllimi është që të ketë një regjistër dhe realisht nuk e kuptoj synimin e fortë të Dhomës dhe këmbënguljen tuaj e shoh pa sens. Ju lutem, na sqaroni pse këmbëngulni kaq fort që subjektet juridike të mos jenë të regjistruara, kur nuk ka asnjë rrezik për ju?!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Hyseni!

Po, zoti Çuçi.

**Bledar Çuçi** – Ne jemi konsultuar edhe me këshilltarët e komisionit për të arritur në një konsensus dhe nuk ia vlen të na marrë kohë, pasi, për të gjithë paketën apo setin me ndryshimet që ne kemi sjellë, nuk është shumë thelbësore. Bashkë me këshilltarët ne kemi sjellë një riformulim të kësaj pike, që mund të na çojë në konsensus. Pra, pika 5, germa “b” “Regjistri i ndërmjetësve duhet të përmbajë emërtimin, llojin dhe selinë e personit juridik të krijuar sipas legjislacionit për tregtarët dhe shoqërinë tregtare, ku ndërmjetësi ushtron veprimtarinë në cilësinë e ortakut, administratorit ose si i punësuar”.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Çuçi!

Zonja Bernhard, fjala për ju.

Ju lutem, për efekt të regjistrimit, filloni përkthimin.

**Agnes Bernhard** - *(përkthen përkthyesi)* Shqetësimi im është se duhet të behet e qartë se vetëm personat e licencuar dhe të regjistruar si ndërmjetës kanë mundësi ta ofrojnë shërbimin e ndërmjetësimit, pavarësisht formës së tyre të organizimit.

**Ulsi Manja** – Dakord.

A jeni dakord me riformulimin që sapo morët?

Urdhëroni, zonja Bushka!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj se të gjithë biem dakord, kur flasim për regjistrin e ndërmjetësve...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Besoj se të gjithë jemi të qartë që në këtë pikë po flasim për regjistrin e ndërmjetësve. E dimë të gjithë se në kuadrin e ekonomisë së tregut, profesionistët e lirë mund të organizohen në të gjitha format e ligjshme për ta ushtruar veprimtarinë e tyre, qoftë si person juridik, qoftë individualisht. Ajo që unë kuptoj, me riformulimin që solli Dhoma, të dakordësuar me ministrinë, ka të bëjë me faktin se rregullat e regjistrit do të bëhen me udhëzim të Ministrisë së Drejtësisë, pikërisht, për të rregulluar edhe çështjet kur nuk ushtrohet si individ, por si person juridik. Pra, nuk është se ne po e ndalojmë, thjesht, duke qenë se ky është një proces, që mund të jetë në evolucionin e sipër, sepse ky është një zanat i ri dhe mund të ketë forma të ndryshme, mund të jetë edhe një shoqëri e thjeshtë, që nuk ka nevojë fare të regjistrohet nesër dhe nuk kemi pse ta shkruajmë në ligj, është thjesht një marrëveshje midis ca ndërmjetësve, që të ndajnë disa shpenzime zyre dhe sipas Kodit Civil, do të ushtrojnë ,në formën e shoqërisë së thjeshtë, këtë lloj profesioni, ama janë ata të licencuarit. Kështu që unë mendoj se, duke ia lënë me urdhër ministrit. U kemi dhënë mundësi ndërmjetësve të ushtrojnë të gjitha format e ushtrimit të aktivitetit tregtar, sipas legjislacionit në fuqi për këtë lloj veprimtarie.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Zonja Bernhard, a jeni dakord me propozimin e bërë nga relatori, zoti Çuçi?

**Agnes Bernhard** - *(përkthen përkthyesi)* Nuk jam e sigurt dhe për këtë arsye nuk mund të shprehem për momentin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Për ju të Dhomës kam një pyetje: çfarë problemi ka për ju germa “b” e pikës 5, sipas formulimit që është në tekstin e projektligjit, sepse më duket se nuk e keni lexuar siç duhet? Flitet për ndërmjetës të punësuar nga një person juridik dhe nuk mund të punësohesh pa pasur licencën e ndërmjetësit. A mund të punësohesh ndonjë person juridik pa pasur licencën e ndërmjetësit?! Për çfarë do të shkosh aty? A ka mundësi ta lexoni edhe një herë? Jo, unë e kuptoj se çfarë shqetësimi keni ju, por problemi është se po të shikosh ligjin në mënyrë integrale, nga neni 1 deri te neni i fundit, absolutisht ka klauzola ligjore, që nuk të lënë të organizohesh në formën e personit juridik në qoftë se nuk ke marrë licencën e ndërmjetësit. Kjo thotë: “Emërtimin, llojin dhe selinë e shoqërisë, emrin, emrat administratorëve dhe emrat e ndërmjetësve të punësuar në një person juridik”. Evidentimi është për efekt regjistri: çfarë problemi krijon për ju? A ka mundësi të ma thoni me dy fjalë, jo duke i rënë larg e larg? Çfarë problemi ka për ju kjo pikë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Katrin Treska** – Ajo nuk licencohet si person juridik, sepse licencohet vetëm nominalisht, të paktën në frymën e gjithë ligjit. Problemi është se një person juridik, i shënuar aty dhe i regjistruar në regjistër, nesër i hiqet licenca X-it apo Y-it, personi juridik vazhdon të rrijë në regjistër dhe na krijon probleme, plus që është evazive përmbajtja.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** - Çfarë problemi krijon?

**Katrin Treska** – Personat, të cilët nuk janë të licencuar, për shkak se janë pjesë e regjistrit, mund ta ushtrojnë aktivitetin e tyre, pavarësisht në mënyrë të ligjshme apo të paligjshme.

**Ulsi Manja** – Pra, të palicencuarit mund ta ushtrojnë profesionin e ndërmjetësit në emrin e personit juridik.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Katrin Treska** – Ne mund ta rregullojmë. Ne jemi shumë dakord me formulimin që bëri zoti Çuçi, nëse mund të shënohet se ky person juridik është i rregulluar në formën e personit juridik, sipas ligjit “Për shoqërinë tregtare”, sepse nesër nuk kemi probleme të forma të organizimit të personit. Domethënë, te kjo pjesë jemi dakord.

**Ulsi Manja** – Ministria e Drejtësisë dhe misioni EURALIUS-it u qartësuar me propozimin e zotit Çuçi?

Ju lutem, ta mbyllim, sepse ka dy propozime mbi variantin e projektligjit dhe do t'i hedhim në votim një nga një, në qoftë se nuk do të biem dakord. Urdhëroni!

**Adrian Shega** – Unë po qartësoj qëndrimin e ministrisë, më pas EURALIUS-i le të flasë për veten e tij. Qëndrimi i ministrisë është, se ligji e përcakton qartë: “Profesioni ushtrohet vetëm nëpërmjet individëve të licencuar”. Parashikime, të cilat mund të hapin derën që profesioni të ushtrohet nëpërmjet personave juridikë, që licencohen nëpërmjet këtyre individëve dhe më pas individët lëvizin, zyra vazhdon të ushtrojë veprimtarinë, ne nuk do të donim që të kishte. Kështu që, për aq kohë sa ajo përcaktohet në ligj apo përcaktohet me akt nënligjor, forma e regjistrimit në të cilën parashikohet vetëm emërtimi i personit juridik, atëherë ne jemi në rregull. Ajo që sugjeroi zoti Çuçi, tregon se ju doni ta vendosni në ligj. Domethënë, ju sugjeroi që emërtimin mos ta lini që të bëhet pjesërisht me urdhrin e ministrit. Kështu që jemi në rregull.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Misioni i EURALIUS-it, a ka ndonjë gjë për të shtuar?

**Agnes Bernhard** – *(përkthen përkthyesi)* Për ne e vetmja gjë që ka rëndësi është që të jetë individi ai që e ushtron ndërmjetësin, jo nëpërmjet Dhomës apo selisë së tij. Në momentin kur kjo është e siguar, ne jemi në rregull me dispozitën.

**Ulsi Manja** – Urdhëroni, zoti Hyseni!

**Alket Hyseni** – Unë e përkrah shqetësimin tuaj, sepse është i drejtë, jo vetëm i EURALIUS-it, por edhe i Dhomës dhe i Ministrisë. Në ligj janë disa parashikime të tjera, që realisht e bëjnë të pamundur krijimin e një subjekti juridik pa licencë të ndërmjetësit. Pra, në tërësinë e tij është totalisht e pamundur. Unë mund t'ju lexoj pikën 1 të nenit 4, ku thuhet: “Ndërmjetësi e ushtron veprimtarinë si person fizik ose juridik nëpërmjet zyrës apo qendrës, pas licencimit dhe regjistrimit”. Pra, askush nuk mund t'i ushtrojë funksionet, as si person juridik, pa u licencuar. Kjo nënkupton vetëm të licencuarit.

Nëse një ndërmjetës organizon një zyrë me 20 juristë të tjerë, kjo nuk përbën shkelje, rëndësi ka që ndërmjetës është ai.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ai mund të kërkojë asistencë, mund të kërkojë sekretari, ne nuk mund t'ia mohojmë këtë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem, a ka mundësi të bëni një formulim, që ta hedhim në votim, sepse në orën 12:00 më duhet ta ndërpres mbledhjen.

Ju lutem, relatorit të bëjë edhe një herë riformulimin!

**Bledar Çuçi** – Germa “b”: “Emërtimin, llojin dhe selinë e personit juridik të krijuar, sipas legjislacionit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, ku ndërmjetësi ushtron veprimtarinë në cilësinë e ortakut, administratorit ose të punësuarit”.

**Ulsi Manja** – A jeni dakord me riformulimin e bërë nga zoti Çuçi?

Ju lutem, lexojeni edhe një herë!

**Bledar Çuçi** – “Emërtimin, llojin dhe selinë e personit juridik të krijuar sipas legjislacionit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, ku ndërmjetësi ushtron veprimtarinë në cilësinë e ortakut, administratorit ose të punësuarit”.

**Ulsi Manja** – Kush është dakord me nenin 7, pikën 5, me propozimin e riformuluar nga zoti Çuçi? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 7.

Kalojmë te neni 21. Për nenin 21 kemi një riformulim të bërë nga misioni i EURALIUS-it, të cilin ju të nderuar kolegë, e keni mbi tavolinë.

Ju lutem, Ministria e Drejtësisë, a është njohur me riformulim e bërë nga misioni EURALIUS-it? A jeni dakord me riformulimin? Dhoma, a është dakord me riformulimin e bërë nga misioni i EURALIUS-it për nenin 21? Jeni dakord.

Ju lutem, të më lexohet për efekt regjistrimi.

A do të shtojë diçka relatori?

**Bledar Çuçi** – Jam dakord me propozimin e bërë, sipas diskutimeve që bëmë në parim, ku ramë dakord për të ndarë qartë rolin e një anëtari, si të thuash, të personit që heton çështjen, nga bordi që merr vendimin. Vetëm propozoj se nuk duhet lënë në vlerësimin e anëtarit hetues nëse ka bazë për të filluar procedimi administrativ, por është bordi që thotë nëse ka bazë për të dhe anëtari merr detyrën për të hetuar, pastaj vjen me raport për ato që kanë dalë nga hetimi. Pra, nuk është në vlerësimin e anëtarit hetues, por është në vlerësimin e bordit nëse ka kushte për të filluar procedimin disiplinor.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për shembull, te pika 5 thuhet: “Anëtari hetues, kur vlerëson se ankesa është e bazuar, fillon hetimin administrativ”. Atë e ka vendosur bordi përpara. Kështu që është thjesht për saktësim.

**Ulsi Manja** – Po, misioni EURALIUS.



**Agnes Bernhard** – *(përkthen përkthyesi)* Besoj se në thelb është e njëjta gjë. Riformulimi i propozuar në pikën 5 parashikon që anëtari hetues, si anëtar i bordit, fillon procedimin dhe vetëm në momentin kur beson se nuk ka arsye për të filluar, i çon një relacion të detajuar bordit për të mos filluar procedimin, pra është bordi ai që merr vendimin final për të filluar ose për të mos filluar. Në momentin që vendos fillimin e procedimit e kalon tek anëtari hetues për të vazhduar me hetimin e çështjes.

**Bledar Çuçi** – Pra, është shumë e qartë te pika 2, ku thuhet se anëtari hetues kur vlerëson se ekzistojnë shkaqe (11/3, 11/4 e këtij ligjit), përgatit një raport në lidhje me shkaqet, pastaj e merr bordi vendimin. Bordi drejtues, kur vlerëson se nuk ka fakte të mjaftueshme, vendos refuzimin. Pra, është bordi që vendos kur nuk ka shkaqe... Pastaj thuhet se anëtari hetues, kur vlerëson se ankesa është e bazuar, fillon hetimi administrativ. Pika 2 lihet ashtu siç është, pika 3 lihet po ashtu, sepse është bordi që vlerëson nëse janë apo jo shkaqet dhe pika 5 mbetet. Unë po propozoj se si duhet të riformulohet pika 5: “Anëtari hetues fillon hetimin administrativ dhe brenda 30 ditëve nga momenti i depozitimit të ankimit...”. Pra, nuk ka nevojë më, se janë kaluar filtrat. Domethënë, nga pikëpamja procedurale e ka marrë rolin iniciues, e ka frenuar bordin kur nuk ka shkaqe dhe në mënyrë të menjëhershme ka marrë vendimin. Ai tani është në pozicionin kur duhet të vazhdojë hetimin dhe, brenda 30 ditëve, duhet t’i japë bordit konkluzionin e raportit të hetimit.

**Ulsi Manja** – A mund të kalojmë në votim?

**Alket Hyseni** – EURALIUS e ka ndarë në dy momente: momenti i parë është kur nuk fillohet hetimi dhe momenti i dytë është kur fillohet hetimi. Në momentin e mosfillimit e kalon në filtrin e bordit, kurse në momentin e fillimit ia lë tagrin vlerësues vetëm hetuesit. Ne gjujmë, kjo është edhe logjikë e relatorit, që në Shqipëri nuk mund t’ia lësh një individ tagrin të vlerësojë ose jo. Le ta kalojmë përsëri në filtrin e bordit. Kur ka, bordi thotë se janë 1, 2, 3 argumente dhe duhet filluar, pra kështu gjykon ai. Kur nuk ka, thotë për X arsye nuk mund të fillojë. Bordi është një organ kolegjal dhe mendoj se ka gjykim më të ftohtë se një individ. Një organ kolegjal është më i prirur të jetë i pandikueshëm se një individ për të gjykuar. Unë mendoj të ndiqet e njëjta logjikë, si për rastin kur nuk ekzistojnë shkaqe edhe për rastin kur ekzistojnë shkaqet, pra të kalojë në filtrin e bordit.

**Ulsi Manja** – Zoti Hyseni, në mos gaboj, pika 5 bën fjalë për rastin kur bordi e ka miratuar fillimin e hetimit administrativ, por duhet të qartësohet, sepse kështu siç është formuluar të kthen pas. Në pikën 5 thuhet: “Anëtari hetues, kur vlerëson se ankesa është e bazuar...”. Ndërkohë, këtu bëhet fjalë për rastin kur bordi ka lejuar fillimin e hetimit administrativ dhe lë të kuptohet sikur kjo është në vlerësimin e anëtarit hetues. Ndoshta duhet

të jetë: “Kur bordi ka miratuar fillimin e hetimit, anëtari hetues mund të vazhdojë... Kur bordi vendos fillimin...”

A mund të bëni një riformulim?

**Alket Hyseni** – Propozim për riformulim të pikave 2, 3, 5. Pika 2: “Anëtari hetues, kur vlerëson se ekzistojnë, ose nuk ekzistojnë shkaqe ligjore të parashikuara në nenin X...” Pra, shtohen “ekzistojnë ose nuk ekzistojnë”.

Pika 3: “Bordi disiplinor vlerëson nëse ka apo nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit, vendos fillimin ose refuzimin e shqyrtimit të ankesës.”

Pika 5: “Anëtari hetues, kur bordi ka vlerësuar se ankesa është e bazuar, fillon hetimin administrativ.”

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Hyseni!

Zonja Bushka, duam një qartësim, ju lutem!

**Klotilda Bushka** – Po ta lexojmë nga pika 1 propozimin e nenit 11/5, që ka sjellë EURALIUS, aty jepet thelbi se si fillon procedimi. Pikat 2 dhe 5 janë të lidhura me dy situata të ndryshme. Pasi ka filluar hetimi, në rastin e pikë 2 nuk ekzistojnë shkaqe. Në rastin e pikës 5 ekzistojnë shkaqe. Unë mendoj se neni është formuluar shumë mirë dhe duhet parë në harmoni me **pikën 1**. Nuk mendoj se ka nevojë për ndonjë ndryshim tjetër.

**Ulsi Manja** – Po, zoti Çuçi.

**Bledar Çuçi** – Le të shohim një rast hipotetik. Vjen një rast për masë disiplinore dhe caktohet anëtari hetues. Rregulli i përgjithshëm është që ai, brenda 30 ditëve, duhet të bëjë raportin në lidhje me hetimin. Në ndërhyjmë për ta ndërprerë këtë hetim vetëm nëse nuk ka shkaqe. Pra, kur caktohet anëtari hetues, rregulli i përgjithshëm është që për 30 ditë duhet të bësh raportin për procedimin disiplinor. Në ndërhyjmë dhe themi, në qoftë se nuk ka shkaqe dhe ai vlerëson se nuk ka shkaqe, nuk ka nevojë të presë 30 ditë, por menjëherë i shkon bordit dhe i thotë se kjo nuk ka shkaqe për procedim disiplinor. Prandaj bordi merr një vendim më të shpejtë. Ndryshe është rregulli i përgjithshëm që, brenda 30 ditëve, duhet të bëjë raportin. Këtë sugjerova ta përmbledhim dhe të shkurtohej. Prandaj ju thashë se nuk ka nevojë të themi “edhe kur ka shkaqe...” dhe “kur nuk ka shkaqe...”, sepse marrëdhënia anëtar hetues-bord është një marrëdhënie: rregulli i përgjithshëm 30 ditë. Kur nuk ka shkaqe, i thotë menjëherë bordit se nuk sheh shkaqe dhe propozon të ndërpritet procedimi disiplinor.

**Ulsi Manja** –Zoti Çuçi kam një pyetje të thjeshtë. Në variantin që propozon EURALIUS-i, a del e qartë ideja që ju sapo prezantuat në komision?

**Bledar Çuçi** – Del, por është zgjatur.

**Ulsi Manja** – Çështje procedurë është. A krijon ndonjë komplikacion në mënyrën si është detajuar procedura?

**Bledar Çuçi** – Në finale nuk krijon, por edhe për estetikë linguistike shkon më shumë kur vendosim një rregull të përgjithshëm dhe përjashtimi nga rregulli i përgjithshëm është vetëm kur s'ka shkaqe.

**Ulsi Manja** – Po, zonja Xhina, ju lutem shumë shkurt!

**Elena Xhina** – Me sa kuptoj unë, merak është te pika 5, sepse anëtari hetues, pasi bën hetimin, paraqet një raport përfundimtar. Unë kuptova se shqetësimi i kolegëve është që raporti të mos jetë përfundimtar, pra hetimi administrativ të mos lihet në dorë të anëtarit hetues.

**Ulsi Manja** – Ai përsëri do t'i shkojë borxhit.

**Elena Xhina** – Jo me raport përfundimtar dhe me propozim për masë disiplinore.

**Alket Hyseni** – Unë do të bija dakord me relatorin nëse i lëmë siç janë pikat 2 dhe 3 dhe vetëm në pikën 5 bëjmë këtë: “Anëtari hetues, përveç rasteve...”

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Po, zoti Çuçi.

**Bledar Çuçi** – Pika 1: Bordi disiplinor fillon procedimin disiplinor duke përzgjedhur me short një nga anëtarët e përzgjedhur nga mbledhja e përgjithshme si hetues të çështjes. Anëtari hetues nuk merr pjesë në votimin përfundimtar të bordit”. Para kësaj, vendosim: “Anëtari hetues fillon hetimin administrativ dhe brenda 30 ditëve nga momenti i depozitimit të ankimit i përcillet bordit raporti përfundimtar në lidhje me hetimin administrativ së bashku me propozimin për masën disiplinore. Anëtari hetues nuk merr pjesë në votimin përfundimtar”, siç është te ligji.

Pika 2: “Anëtari hetues, kur vlerëson se nuk ekzistojnë shkaqe ligjore dhe ato të parashikuara në nenin 11/3, 11/4 të këtij neni, përgatit raportin në lidhje me shkaqet”. Pra, nuk pret 30 ditë, por menjëherë, kur konstaton, shkon te bordi.

Pika 3 mbetet: “Bordi disiplinor kur vlerëson...”

Edhe pika 4 mbetet: “Në rastet kur raporti nuk përmban informacion të qartë.

Pika 5 hiqet fare, sepse pjesa më e madhe e pikës 5 shkon te pika 1 si rregull i përgjithshëm dhe pastaj kalojmë direkt te pika 6.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Çuçi!

Bëjmë 10 minuta pushim, me qëllim që këshilltarët e Komisionit, Ministria e Drejtësisë, Dhoma dhe përfaqësuesit e EURALIUS-it ta shohin këtë nen, pastaj rikthehem këtu për ta votuar në tërësi.

*(Rifillon mbledhja)*

**Ulsi Manja** - Ju lutem, njoftoni mediet të vijnë, që të rifillojmë mbledhjen e komisionit!

Vazhdojmë mbledhjen me shqyrtimin e nenit 21 të ligjit, të cilin e kemi lënë të hapur. Pati një riformulim të nenit 11/5 të bërë nga misioni EURALIUS. E shtymë shqyrtimin për të pasur një dakordësi për riformulimit të këtij neni pas sugjerimeve dhe komenteve të kolegëve. A ka një riformulim të dakordësuar për nenin 11/5 të projektligjit nga relatori i komisionit, zoti Çuçi?

**Bledar Çuçi** – Po, besoj se u sqaruam edhe me misionin EURALIUS, që e bëri këtë propozim, edhe me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, me të cilët e diskutuam. Besoj se duke e bashkuar atë që ishte pika 5 me pikën 1 si rregull i përgjithshëm me formulimin që unë bëra dhe, duke e hequr pikën 5, e cila bashkohet me pikën 1, duke lënë përcaktimin e përjashtimit nga rregulli i përgjithshëm (në rast se nuk ka shkaqe brenda 7 ditëve i propozon), e plotësojmë nenin dhe arrijmë në një përkufizim që i kënaq të gjithë.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Çuçi!

A jeni dakord me riformulimin e bërë?

**Agnes Bernhard** – *(përkthen përkthyesi)* Po, e pranojmë.

**Ulsi Manja** – Pra, jeni dakord me propozimin e bërë për nenin 11/5, që i përket nenit 21 të projektligjit?

**Bledar Çuçi** – Më falni, kryetar!

Ndërkohë, diskutuam edhe për rastin, të cilin e prekëm edhe në mbledhjen e fundit, i cili ka të bëjë me rastet kur bordi është me numër çift anëtarësh për shkak të ndonjë pamundësie të ndonjë anëtari, apo për faktin që një anëtar hetues s’do të jetë në procesin vendimmarrës. Mund të kemi shpesh raste të tilla. Ka rregulla të përgjithshme për funksionimin e organeve kolegjiale, por ne mendojmë ta fusim drejtpërdrejt dhe ta rregullojmë në ligj, përkatësisht në nenin 11/2, pikërisht aty ku flitet për bordin disiplinor (nga sa anëtarë përbëhet dhe se si ngrihet ai), të shtojmë një fjali pas pikës 2 të nenit 11: “Në rast të rezultatit me vota të barabarta pro dhe kundër, vota e kryesuesit të mbledhjes është përcaktuese.” Sigurisht, kur është kryetari e kryeson ai, por ka edhe raste kur nuk është kryetari për shkaqe të ndryshme dhe kryesues i mbledhjes do të jetë dikush tjetër, kështu që vota e kryesuesit të mbledhjes është përcaktuese në rastet, kur rezultati i votimit është i barabartë. Ky është marrë nga rregulli i përgjithshëm, por është me interes ta përcaktojmë këtu, që të mos kemi asnjë diskutim më pas.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Çuçi!

A janë dakord me propozimin e bërë përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, të Dhomës dhe të EURALIUS-it?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Agnes Bernhard** – *(përkthen përkthyesi)* Po, e pranojmë.

**Ulsi Manja** – Atëherë, hedhim në votim nenin 21 të projektligjit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Urdhëroni, zonja Bernhard!

**Agnes Bernhard** – *(përkthen përkthyesi)* Kam një sugjerim për nenin 11/7 në mënyrë që të reflektohet edhe fakti që anëtari hetues nuk ka të drejtë vote. Riformulimi që kërkohet është: te pika 1 në procesin disiplinor, bordi disiplinor merr vendim me shumicën e anëtarëve me të drejtë vote.

**Ulsi Manja** – A jeni dakord me propozimin e bërë nga zonja Bernhard për të saktësuar nenin 11/7?

**Bledar Çuçi** – Dakord.

**Ulsi Manja** – Dakord. sepse anëtari hetues nuk ka të drejtë vote.

**Agnes Bernhard** – *(përkthen përkthyesi)* Përsëri tek i njëjti nen, te pika 3 e tij, ka këtë riformulim: “Vendimet përfundimtare të bordit disiplinor bëhen publike në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, duke siguruar mbrojtjen e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi.”

**Ulsi Manja** – Dakord. A jeni dakord me propozimin e bërë nga zonja Bernhard?

**Bledar Çuçi** – Dakord.

**Ulsi Manja** – Hedhim në votim nenin 21, me ndryshimet e propozuara nga relatori, për nenin 11/2, nenin 11/5 dhe nenin 11/7 për të cilat u dakordësuar me Ministrinë e Drejtësisë, Dhomën, misionin EURALIUS dhe kolegët deputetë. A i mbajti shënim këshilltarja sugjerimet dhe riformulimet e bëra në nenin përkatës, sipas variantit që u diskutua?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, janë mbajtur shënim dhe do të reflektohen në tekstin integral të projektligjit edhe ndryshimet e bëra te neni 7 pika 5, edhe te neni 21, sipas riformulimeve.

Kush është dakord me nenin 21?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve””.

Kush është dakord në tërësi me tekstin integral të projektligjit, pas shqyrtimit nen për nen të tij? Pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve””, sipas tekstit integral, i cili do t’i bashkëngjitet raportit, që do t’i shkojë seancës plenare, ku janë reflektuar nen për nen të gjitha sugjerimet, komentet dhe riformulimet e bëra nga kolegët deputetë, të dakordësuara me Ministrinë e Drejtësisë, Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësimit dhe me misionin EURALIUS.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Besoj se edhe çdo ligj tjetër do të kalojë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dua të falënderoj kolegët deputetë për durimin dhe për përkushtimin për miratimin e këtij projektligji. Ky është projektligji i parë i paketës së dytë të ligjeve të reformës në drejtësi, të cilën komisioni ka aktualisht në dorë.

Dua të falënderoj propozuesin e projektligjit, relatorin, si dhe të gjithë kolegët deputetë, të cilët u përfshinë në diskutimin e këtij projektligji.

Dua të falënderoj edhe mediet për vëmendjen që kanë treguar në pasqyrimin me transparencë të këtij diskutimi.

Dua të falënderoj në mënyrë të veçantë misionin EURALIUS, zonjën Bernhard, për impenjimin e saj të drejtpërdrejtë në miratimin e këtij projektligji, Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën, e cila e ka ndjekur hap pas hapi diskutimin e këtij projektligji.

Edhe një herë, faleminderit!

E mbyllim këtu mbledhjen e komisionit për ditën e sotme.

Mbledhja e radhës së bashku me rendin e ditës do t’ju njoftohet nga sekretaria e komisionit. Faleminderit! Ditë të mbarë!

**MBYLLET MBLEDHJA**